



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Përmbleno Më/Dana 01-02-2024, vit./ops.			
Nr. i organit / Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë / Prilog	Vlera / Vrednost
01-	060	01-	120



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dispozitat e nenit 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012, MPB, 03/2012 të MAPL-së për këshillat komunale për siguri në bashkësi dhe nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2024 miraton këtë:

V E N D I M

për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për Vitin 2024

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për Vitin 2024.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për Vitin 2024, me Nr. të Protokollit 02-052/03-1477, i datës 12.12.2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) për Vitin 2024 kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi

